


# NORMALISTI

Jo në dijën, por në vullnetin e fortë  
qëndron vlera e njeriut.

HERBERT



QIMI L. K. I

DHURUAR  
NGH

FANI  
KAMATI

## Mbrendija

1. Kureshtija fëmijore e mënyra e të lavruemit faqe	1
2. Rreth individualitetit të fëmijë	2
3. Fëmija me shkollën	4
4. Provë mësimi	5
5. Plan mësimi — Rendi III-ë (Gjuhë)	6
6. Plan mësimi — Rendi III (Vizatim)	7
7. Vepimi i punës mbi karakterin	8
8. Besimi i vet vehtes	9
9. Në vetmin e fshatit të qetë	10
10. Djetmëria	11
11. Zojusha e qytetit me cigare në gojë	12
12. Lamtumirë një shokut të humbur	13
13. Fortesa e Tepelenës: një fantazmë e shekullit	14
14. Të Përkohshmes "Normalisti", Elbasan	16
15. Z. Z. Mësimi, mësues dhe nxënës normalista	17
16. Malli t' im	17
17. Larg vendlindjes	18
18. Kopështi shkollor	19
19. Shtatë e vitit	20

E përkohshmeja "NORMALISTI",  
Elbasan

E botonjë nxanësit e Normales

Botues i Përkohshme: P. TINEFI

Përtitimi: Për gjashtë numra 1 Fr. arti

Një numër kushton 1 Lekë



# NORMALISTI



RIVISTE PEDAGOGJIKE, LETRARE, SHKENCORE  
BOTOHET PREJ NXENESVET TE SHKOLLES NORMALE — ELBASAN

Nr. 3

ELBASAN, TETOR 1934

VJETI VI

## Kureshtija fëmijore e mënyra e të lavruemit.

prej John Locke "Mendime mbi edukaten" fq. 118-21.

Kureshtija e fëmijve nuk është tjetër veçse dishir të të njoftuni; prandaj duhet të trimohet e të perkrahët, jo vetëm si një shëj, a mzirë e mirë, por edhe si një vegël e madhe falë prej natyre për të davaritë padijën, në të cilën kemi lë. Padija, kishte për të na bër krijesa trashanike e të pavlerë, po të mos kishim ket shpirt kerkese. Mjetet për ta trimnue e përkrahë, mbas mendimit t'ëm janë këto:

1. Mos me pëngue as me prapue as një pyetje të fëmij as me lanë qi të vëhet në shpoti, por me iu-pergjegjë të gjithave e me i shkoqitë atë qi don me njoftë në mënyrë që të ja bajin, sa më të qartë të jetë e mundun, për derikū ta lejojë moshën e tij e njohit e tija. Nuk duhet, por, të ja ngatrojn mendën me shkoqitje e njohi anā të naia se fuqija e tij mendore, ase me një ndryshmëni të madhe a shumicë gjanash, të cillat nuk i perkasin asajë rase. Nder pyetje të tija duhet të keni kujdes me i ra në të se shka don të thotë e jo me u vū mend fjalëve, me të cilat aj tfaqet. Kur ta keni kuaqë, tue i kallxue shka aj kerkote, keni me pā se si ka me u zgjanue orizonti i tij e se si keni për të muejtë, me pyetje të zgjedhuna, e me perçue fort mē larg se mund ta mendoni.

Puna është qi të njoftunit i kander mendes sikurse drita syve. Fëmijët kuaqen ē gëzohen fort me njoftë, sidomos kur shofin se pyetjet e tyre merren para sysh e dishiri i tyre për të njoftë trimnohe, perkrahët e levdohet.

Un jam i sigurtë se një nder shkaqe më të para qi shtyjn fëmijët me u dhanë krejtësisht

mbas sportizmësh trashanike e me mbytë krejt kohen e tyne në marrina, është puna se shofin të shkueme huq kureshtin e tyne e të lanuna më një anë pyetjet e tyne.

Un nuk dyshoj se, po të merrreshin ma njerzish e mē me nderim e po të ju epeshin pergjegje të kuaqshme pyetjeve të tyne, do ta merrshin ma me qejf punen e të nxanunit e të përmirsimit të njohurve, në të cillat o të gjejshin gjithherë gjana të reja e të ndryshme, qi i gëzojn, se sa të persrisin padā po ato lojë e të marrin nëpër duer gjithherë ato ringxhinge.

2. Jo vetëm qi u duhet pergjegjë me gjith mënd pyetjeve të tyne e u duhen dhanë ato drejtime e skjarime, qi dishirojn, sikurse t' ishte një gjasend, qi me të vertetë ka randësi për to, por duhet medjë me trimnue e perkrahë edhe ndryshej kureshtin e tyne.

T'u flitet atyne për njoftim, qi kan n' atogjana njata nierz, qi ata nderojn. Mbassiqi na që në djep jena të gjith krijesë krenare e kryenalla, t'i apin ksajë kotnije një kënaqje qi t'i bajë të mirë e ta sjellim kryenaltësin e tyne në një gjasend, qi mund t'u jetë e dobishme. Keni me u kujtue se nuk ka shtytës ma të mirë, për t'i dhane shkas të paralindunit 1) me nxanë e me njoftë një gjasend, se sa me e ngarkue atë qi të ja mësojë vllazenve e motrave të veta mē të vogla.

3. Sikurse nuk duhet kurr me perbuze pyetjet e fëmijve, është duhet me ju reshtë të dhannit të gjeqjeve të rrëshme a të pacakiueme.

1) i paralindun = djal i parë.

Fëmijët kuptojn lehtësisht kur i mashtrojm a i perbazim e shpejt mandej mësohen me kenë të pazellshëm të shtinatun kah shofin se tjerët po i perdorin kto harte. Na kurr nuk duhet t'i bajm lark së vërtetës n' asnjë bisedë, e aq më pak me fëmij. Perse në kje se na i shpotisim i sjellim me fjalë jo vetëm qi u a rrejim shpresen e u a ndalojm të njoftunit, por perdhosim edhe pafajnin e tyne tue u mësue atyne vesin më të keqin.

Ata janë shetitësa t' arrijtun njatëherë në lagje të huej, së cilles s'i njoftin kurgjâ; prandal na duket të ja xamë vedit per gabim të madh n' rrejshim. Me gjith qi ndojherë pyetet e tyne na duken të padomethanje, me-gjithatë u duhet pergjigjë me gjith mënd: perse, edhe në kje se në na duken tse lu kemi gjegjë tash sa kohë) pyetje të kota, e kan gjithmonë st randësin e vet per ata qi nuk diejn kurgjâ. Gjithshka na njoftin, fëmijët nuk i diejn. Të gjitha gjanat, në të cilat hasin u duken të reja në fillim, sikurse kje ne dikur per në. Ata janë të lum kur ndeshin në nierz të dashtun, q'i bashkohen e ulen në padljen e tyne e u ndimojn me dalë soje

Po t'u gjindshim ju o un në Japan me gjith urtësin e vetëdijen t' onë, të cilat janë ndoshta shkaku i përbuzjes, qi kemi për mendimet e pyetet fëmijnore, po t'u gjindshim persris na në Japan është sigurtë se (në kje se duem me diejt shka është per t'u njoftë m' at vend) kishim me bā njini pyetje, të cilat një japanezit krenar o të pakujtueshem do ti dukeshin krejtësisht të marra e të merzitëshme, nësaqi per në ato do të kishin randësi të madhe. Na kishim me kenë të gëzuem po të gjëjshim një nieri aq të pelqyeshem e t' ardhshem sa të knaqi pyetet t'ona e të davarisë padijen t' onë.

Kur fëmijët ndeshen në ndonji gjâ të ré kan zakon me bā pyetjen e përdorshme të njaj të

hueji: «Shka është?» Me këtë ata shumë herë nuk kerkojn me diejt veçse emnin e gjâs. Prandaj gjegja, qi lypet në ket rasë qindron pergjithsisht në të dëftuem të ktij emni.

Tj tra pyetje, qi vjen me herë mrapa zakonisht është: «Shka vyen?». Edhe ksajë kishte me u dashtë t'i pergjigjeshim trejtë-per së drejti e me siguri. Do t'u dote t'u diftohej perdorimi për të cilin vyen edhe mënyra e të perdorunit, me fjalë, qi i pershtaten zotsis së tyne mendore.

Ndiqu po at mënyrë ecunije në të gjitha rrethanat tjera, qi pyetet e tyre mund të shkaktajn, e mos lëni kurr qi të ju ikin pa u pasë dhanë atyre gjith n'at kënaqësi, qi janë të Zott me shijue.

Kshtu kenë me i perçue me anë të gjegjeve tueja, me ju bā tjera pyetje. Mundet qi një bisedim i tillë mos të dalë i kotë e padomethanje edhe per një të rriteshem, sikurse zakonisht besohet. Pyetet e natyrshme e të parapame të fëmijve kureshtarë napin shpeshherë lëndë me vù në veprim edhe menden e një nieri perbaltuer (refleksiv). Un jam i mendimit se shpeshherë ka mē tepër shka nxën nieri prej pyetjeve të paprituna të njaj fëmije, se prej bisedëve të nierzve, qi flasin per zakon mbas njohëve të marruna andej e kndej e paragjikimeve të edukatës së tyne.

4. Ndoshta do t' ishte mirë mos me e lanë mbas dore ndojherë të nxitunit e kureshtis së fëmijve, tue u diftue atyne gjana të reja e të çuditëshme me qellim qi t'i shtyejm në pyetje e t'u apim rasë mandej qi ata prej vedit t'i bien në të punës.

Në kje se nodhë mandej qi kureshtija e tyne t'i shtyjë me pyetë gjana, qi nuk duhet t'i diejn, është shumë më mirë tu thoni troç se ato huk janë gjana, qi u perkasin atyne me i njoftë, sa t'i mashtrojm me gjegje të rrëme a të kota.

K-i

## BRETH INDIVIDUALITETIT TE FEMIS

Nji çeshtje me rëndësi në punë t'edukatës është edhe të njoftunit e shpirtit të fëmij, d. m. th. të njoftunit e gjithë dispozitavet mendore e trupore të saj. Për të pasë edukata një përfundim të mirë, duhet që kjo t'i përshtatet rrethit,

kohës, racës, moshës dhe vëndit e gjithë rrethnavet shoqënore ku rron fëmija. Por që t'i përshtatet edukata gjithë këtyneve, duhet më parë të njoftim vëndin, rrethim e më tepër të njoftim fill e flakë nxënësit që do të edukojnë (indivi-

dualitetin e tyre), që kështu të dijme si t'i rrisim.

Shumë herë shofim se në klasë na dalin pengime të mëdha dhe nuk marrim ato përfundime që kërkojmë. Kjo gjë rrjeth më të shumtën rë nga që nuk i njohim nxënësit e një klase ashtu si duhet dhe i fabrikojmë të gjithë mbas një kallupi, pa marrë para sysh moshën e një nxënësi të veçantë, gjendjen familjare, përkrahjen mendore dhe prirjet e tij. A nuk është një punë e kotë dhe pa përfundime të mira me pritë një lloj pune si prej një nxënësi 10 vjeç, si prej atij 7 kur këto janë po në një klasë? A nuk është një punë e paarësyeshme me pritë po ato përfundime si prej një nxënësi pasanik që i ka të gjitha me rregull në shtëpi dhe që nuk i mungon as kujdesi i prindit, si prej atij që nuk ka as tryezë shkrimi por shkruen e këndon për tokë e shumë herë s'ka edhe kalem dhe prindët jo që nuk i ndihmojnë, por kërkojnë edhe të gjitha punët e shtëpis prej tij? A nuk është një gjë jashtë llogjikës me pritë prej një nxënësi që i mungon inteligjenca e duhur, ose kujtesa e duhur, ose kujtesa a vemendja, ose prej një idioti aqë sa mund të presim prej një normalisti?

Të gjitha këto luejnë një rroll me rëndësi si në të trajtimit e nxënësvet, ashtu dhe në mësimin e në gjykimin që epet mbi to. Prandaj hapi më i parë për njoftjen e tyre duhet të bëhet qysh ditët e para të shkollës, tue bërë prova mbi të pamurit, të ndërgjuemit, mbi vemendjen e inteligjencën e tyre, që kështu nxënësit e gjytmë të vendos në vëndë ku mund të përfitojnë më tepër. Askush nuk mund të thot se nuk ka në klasë të tij nxënës që nuk shofin a nuk ndëgjojnë mirë, mbassi shumë herë këto të meta janë aqë të mëqelja, sa që është zor me i kuptu. Por me gjithë atë, mund t'i kuptojmë me disa prova të thjeshta, si p. sh. për të pamurit tue i paraqitë fëmijet të vegjël sende të pikturueme, si orë, karrikë, kutija etj. dhe të mëdhenjve fjalë të shkrueme në largësi të ndryshme (7 m). Për të ndërgjuemit, tue i bërë nxënësit me ndërgjue me largësi të ndryshme tik-takun e orës, zanet e njerësvet, tinguj metalesh etj. Për inteligjencën, tuj kërkue prej të vegjëlvet spjegime mbi ilustracione të ndryshme dhe prej të mëdhenjvet kuptimin e disa fjalëve të vështira, ose me gjetë me kohë të caktueme një sasi emna kafshësh etj. Të gjitha këto prova mund

të bëhen edhe gjatë vitit ndër kohë të ndryshme. Vetëm në këtë mënyrë do të mundim të kuptojmë shkaku e vërtetë të dobësis së secilit nxënësi dhe ta rregullojmë mësimin simbas këtyneve, tue pritë prej secilit aqë sa mundet aqë sa ia rrok horizonti menduer i tij dhe jo sa mund të marrim prej më të mirit të klasës.

Shumë herë, nga që mësuesi nuk i njeh nxënësit e tij edhe nga që pret prej të gjithëve po një punë, rrjeth i mbetunim në klasë të një sasisje të madhe nxënësishe, e cila gjë është një fatkeqësi për to. Kështu p. sh. ka ndodhë që në për klasë me nxënës jo më tepër se dyzet të mbesin 12-13 për ta përsëritë klasën. Mund të thomi se ka shumë të ngjame që këjo gjë të ketë rrjedhë nga që mësuesi nuk ka mundë me i njoftë mirë nxënësit e tij nga gjendja e tyre psikike ose nga jeta familjare.

Por edhe në qoftë se arësyeja e mbetjes në klasë të një shumice nxënësishe vjen nga mungesat e shumta, (sikurse ndoth shumë herë), prap faji nuk asht ke nxënësit; se mësuesi duhet të përpiqet të kuptojë shkaku e vërtetë të mungesave dhe në marrëveshje me prindët t'i pakësojë këto, mbassi po të gjindet shkaku asht kollaj përmirësimi.

Një rëndësi ka edhe puna e prirjevet të fëmijë. Disa janë të zot në shkathtësi dhe në njohni s' dëftojnë zotësi; disa të tjerë janë të mirë në matematikë dhe të dobët në gjuhë etj. Në të mesuemit e këtyne nxënësvet, duhet me i dhanë një rëndësi të madhe landës në të cilën ai ka prirje, tue pritë shumë prej atij në këtë landë, mbassi në këtë ka se ç' të nxjerri prej forces së tij dhe në landën ku nuk ka prirje, me u mjaftu me pak.

Në këtë mënyrë do të shkojë mbarë puna e klasës dhe numuri i të mbetunvet në klasë do të jetë shumë i pakë.

Gjithashtu edhe për nxënësit anormalë a të metë duhet të mjaftohemi me sa më pak që të jetë e mundun, mbassi këta mund të përmirësohen vetëm nëpër institute të veçantë dhe jo tue ndejtë 3-4 vjet në një klasë e tue humbë kohë në bankat e shkollës.

S. Papanisto '30



# FËMIJA ME SHKOLLËN,

## dy faktorët më me rëndësi për të përhapur t të kulturës.

Duhet ditur se mësimet e shkollës do të lidhen me ato të shtëpisë e në bazë të këtyre do të vepërojnë, sepse shkolla nuk' është gjë e veçuar e që mbahet vetë, por rrjeth prej familjes, është një vijim i 'saj dhe nuk duhet ta ndajmë, në qoftë se dëshërojmë të shohim dobi.

Familja dhe rredhi familjar është shkolla m'e parë dhe m'e gjatë për zhvillimin e virtytevet shoqërore, prandaj, sa më fort këjo t'i japë dorën shkollës, aqë më tepër përfitohet dhe aqë më tepër i vihen themelet mësimi. Sa dëm sjell grindja ndërmjet të anëtarvet të familjes, aqë sjell dhe dizarmonija e shkollës me familjen, kur këto nuk vepërojnë së bashku e nuk shkojnë krah për krah me një udhë miqësore e plot kuptim. Familja me shkollën janë ari dhe atmosfera, që ushqejnë e fuqizojnë telëzat e një peme, e cila një ditë do të japë lule të shkëlqishme e pemë të shijëshme.

Nevoja e shkolles rrodhi prej mungesavet të familjes sepse këjo e fundit, mbassi nuk ishte në gjendje që t'u japë fëmijvet mësimet e duhura, mesimet e nalta, kerkoi atë që do t'ia plotësonte këto të meta: shkollën me mësonjësin, dy shtyllat që do të bëjnë që të mbijë në zemrat e njoma të të rinjvet idealë bujarë e ndiesira të larta. Shkolla duhet të merret vesh me prindërit mbi gjendjen e fëmijes d. m. th. ajo është që bashkëpunon me familjen, moassi nuk është gjë tjetër veçse një bashkim shoqëror i vogël ase është një plotësim e zmadhim i edukatës shtëpiake. Mirëpo edhe familja duhet të bashkëpunojë me shkollën; duhet të ndihmojë veprën e shkollës dyke i dhanë fëmijës një edukatë morale e besimtare d. m. th. t' interesohet për të mësuar me një ndërgegje, njerëzi, urti, kujdesi e perpikëni; kësisoj që fëmija të jetë i gatuar për një edukatë shkolllore, e cila do të lehtësohet, sikur edhe fëmija të mos ketë as më të voglën njohni.

Familja duhet ta çmojë shumë lart shkollën, dyke punuar për lartësimin e saj, dyke menduar shkollën si banim të dytë për fëmijët e 'saj;

Familja të jetë shëmbëll, pse është m'i pari

institut edukativ; duhet prandaj, që, gjatë kohës së vijimit të fëmiës në shkollë, ta ndihmojë veprën e shkollës dyke e mbajtur lart e më lart autoritetin e mësuesit të shkollës, e të mos sjelli pengime si p. sh. dyke e ndaluar fëmijën në shtëpi pa dijen e personelit mësimor.

Mirëpo cila familje do t'i bëjë këto? Ajo që piestarët e 'saj babë, vëlla e tjerë, mbushin kafenet dhe nuk përkujdesen për edukimin e fëmijës? apo ajo familje rreth së cilës nuk mbretëron gjë tjetër veçse imoraliteti, pabesimi, pandegjësia, tiranija, grindja, pija, nema e tjera? Për fëmijët e të këtilla familjevet, mësimet e shkollës nuk bëjnë asnjë efekt e nuk u ngjiten kurrë në shpirtin e tyre. Shkolla për të këtillë fëmijë fatkeqë, vetëm prej vehtes së 'saj e si është, sa do të mundohet me mjetet e saj edukative, nuk do të bëjë gjë e t'u shillojë dashurin, nderin, mirënjohjen, bujarin e tjera. Shkolla doemos do të gjejë vështirësi ndër ato familje, që kanë një rrugë të kundërt prej 'saj dhe do t'i venë kot po qe se në shtëpi ata do të gjejnë të kundërtat. sepse shkolla rrenjos ato që mund të mësojnë në shtëpi dhe i përbusha i plotson sa nuk mund të fitojnë në shtëpi, por vetëm atëhere, kur do të gjejë një truall të mirë për veprën e 'saj, kështu që ferat e hedhura të mbijnë të gjalla e të fuqishme.

Prej sa thamë, pra, kuptohet se puna m'e parë qendron tek familja; ajo duhet të rrethohet me një ambient, ku fëmija të mos mund të marrë veçse shembuj të mirë mbassi ay prej shembujvet që rrethojnë nxier elementet me të cilat ndron personalitetin e 'tij. Ja ç' farë thotë një dijetar: «Një shtëpi e ëmbël dhe i hijëshme ku fëmija merr puthjen e nënës e përkëdheljen e babës, është mësimi m'i parë për t'u-bërë qytetas i mirë.»

Ne duam që të edukojmë popullin e ta ngremë në një nivel me përparimin e soçme, duhet pra që të bëjmë shtëpinë, shkollën më kryesore të zonjën për të përmdashur rolin e 'saj e këjo bëhet, kur të dimë të bëjmë nëna të mira, sepse lumnija e jonë është në duart të 'tyre. Duhet

# PROVE MESIMI

## Dhanë në klasën e I rë t' Ushtrimores

Landa: Gjuhë.

Thema: Diktim, «Punët e bujkut në verë».

**Paragatitja:** Paragatitja i hynë në punë mesuesit, qi, parafytyrimet e vjetra; të cilat i ka fitue fëmija në familje, në rethin shoqëruer ku rron edhe në shkollë, të mund të nxiten dhe të mund të rrishtelin në vetëdijen me anën e parafytyrimevet të raja, qi do të fitohen në mësimin përkatës.

Pyetja më e përshtatëshme për hyrje, është kjo: «Kush din me më kallzue prej jush, se ç'farë punësh bân bujku në verë? Kjo pyetje është shumë e gjënë, d. m. th. se me anë të kësaj nxirren shumë përgjigje. Por kjo bëhet me qëllim, qi t'i përsrisin shkurt gjënat, qi i kanë mësue në orën e I rë të mësimi të jetës: «Punët e bujkut në verë».

**Paragatitja:** Mbassi pyetja e hyrjes është shumë e gjënë, nxënësit do të flasin gjënë e gjatë mbi punët e bujkut në verë. Por mesuesi duhet me pasë kujdes, qi t'i përçojë në një rrugë të natyrishtme të menduemit të 'tyne. Pun' e parë e bujkut është të kosinunit e barit; mandej punon rreth misrit, prashit, ujit e më në fund i korr të lashtat. Kuri korr të lashtat, bujku i çon në lamë me i shimë, etj.

**Ushtrimi:** Mbassi të përflitet lirisht me nxënësit mbi punët e bujkut në verë, i pyet mesuesi nxënësit: «Mbi ç'farë folëm ndashti? «Nx: «Mbi punët e bujkut në verë». Kjo fjalë përsëri-

lartësimi shoqëror i gruas në syt të fëmijës e të qarkut të 'saj, sepse, kur mema është e urtë e përgjithësisht e vërtetëshme, edukata fitohet vetvetiu dhe e sigurtë; po të mos kemi nënë të mira prishet jo vetëm familja, por edhe një shtet i tërë.

Vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet një familje, e cila ka për krah me shkollën do t'arrijë qëllimit të dëshiruar dhe po në këtë mënyrë do t'i jepet mesuesit kuxim për të qendruar i patutur në veprën e rëndë edukonjëse, që ka marrë përsipër.

Rahmi Hoxha '31

tet prej mesuesit pa fjalëzen «Mbi: «Punët e bujkut në verë.» Kjo fjalë përsëritet prej disave mandej thohet horas prej të gjithëve. Mandej u thohet nxënësvet, se këtë do ta shkruajnë në fletore. Mës: «Radhojt jasht—1, 2, 3!» . . . Pëndat nalt! Fjalija përsëritet edhe një herë, mandej u thohet nxënësvet se duhet ta shkruajnë në vijën e parë, në mës. «Shkrueni!» —«Punët. . . ; mesuesi u diktton nxënësvet fjalën fjalë për fjalë, me një ton të vulltëshëm dhe me ngadalë. Kur e diktton fjalën, mesuesi nuk e shkruen me një herë, por pret pak sa të fillojnë të shkruajnë nxënësit. Mbassi të mbarohet fjalija, pyeten nxënësit: «Çdo të vëmë në fund? (Nx: pikë.) Edhe në çdo fjalë t'jetër veprohet në këtë mënyrë.

Vazhdon diktimi, tue përgatitë fjalitë. Mës. «Ç'punë bân bujku në verë herën e parë?» Në qoftë se s'kujtohen nxënësit, i kujton mesuesi: «Bujku merr një kosë në krah dhe vetë në për livadhe. Ç'farë thoni se bân ai me kosë nëpër livadhe?» (Nx . . . . .). Këtu nxiten nxënësit, qi ta thonë më bukur fjalin: Bujku në verë kosit barin.

Mës: «Mbassi e kosit barin bujku, a e len në livadhe? (Nx . . . . .) Këtë e ven në mutlar.

Mës: «Në verë ka bimë misri; bujku tashti merr një shtat dhe vetë ke ara, ku ka mbjell misrin; ç'farë bân ai atje?» (Nx: Ai prashit misrin) Në verë është vapë e madhe, prandaj arat e misrit thahen, por bujku, qi të mos thahen, u-bân dishka t'jetër; (Nx . . .) «Ç'farë i bân bujku misrit? Kush din më ma thanë bukur.» Nx: «Ai në verë prashit dhe ujit misrin».

Mës: «Mbassi e kosit barin dhe mbassi e prashit dhe e ujit misrin bujku, a nuk punon më?» (Nx . . . . .) «Ç'farë iu bân bujku të lashtavet në verë? Nx . . . . . Bujku në verë i korr të lashtat. Mës: Mbassi i korr të lashtat, ku i çon ato? Nx . . . . . Ato i çon në lamë. Mës . . . Po ç'farë bân atje? Nx . . . i shinë me kujë.

Mës . . . Kush do t'a thotë më bukur? Nx . . .

Ato i çon në lāmë dhe atje i shinë me kuaj.

Mës. . . Shifni, pra, se sa punon bujku i shkretë; ai mbjell, kosit, korr, prashit e ban shumë punë tjera me fuqi e me mundim të math; si thoni pra ju, për këto punë që ban bujku a duhet t'a duem e t'a nderojmë? Nx. . . Ne duhet t'a duem e t'a nderojmë shumë bujkun se ai punon gjithë ditën.

Fjalitë që përpunohen bashkë me nxanësit, do të fliten prej mësuësit me ngadalë tue i shkëruar edhe tue i dalluar mirë fjalët njana nga tjetra; mos të përsëritet kurrë një fjalë dy herë, sepse nxanësit tue e kujtue për tjetër fjalë, e shkruajnë në dy herë.

### Tabela e Mësimt

Punët e bujkut në verë.

Bujku në verë kosit barin. Këtë e ven në mullar. Bujku në verë prashit dhe ujit misrin. Ai korr të leshtat. Këto i çon në lāmë dhe i shinë me kuaj. Ne duhet ta duem e ta nderojmë shumë bujkun, se punon gjithë ditën.

Gani Dau '32

## PLAN MËSIMI

dhanun në klasën e III<sup>të</sup> të shkollës  
Ushtrimore. Ora e IV<sup>të</sup>.

Landa: Gjuhë.

Thema: Të mësuem përmendsh "Kënga e Gjelit"

Sikurse dihet mësimi do të fillohet me një hyrje të volitshme, e cila do të ketë për qëllim që të zgjojë interesin dhe të lidhi mësimin e ardhshëm me qarkun e njohjeve të nxansve.

Si hyrje për këtë mësim, mund të vlejshëm shumë, por më e përshtatshmeja dhe që ka një lidhje me vjershën është kjo:

Paragatitja: M, një ditë Zotnija i kishte thënë Petritit që t'i bante hesapet mirë e pa gabime në shtëpi. Ky porsa hangër bukë në mbramjet shkoi me fjetur sepse i vinte gjumi edhe e porositi nanën e tij që ta sqontë hejëret për me pregetitun mësimin.

Kur po gëdhinte në mëngjes në për gjumët ndegjoi zanin e një shpeze të bukur shtëpijake. Çfar shpeze do të ketë qenë kjo? Pa dyshim mbas disa përgjigjesh prej nxanësve do të dali edhe gjeli.

Paraqitja: Po si këndon gjeli? Nx. . . . .  
kikiki riki. Këtu nëntën nxansit të kallzojnë edhe zanin e një gjeli të vjetër, e tue i ardhë për qark një gjelf tjetër: kukuku-ruku.

Këto dy zana imitohet prej nx. veç e veç e horas diza herë kështu që t'i shqyptojnë pa gabime në të mësuem të vjershes, masandaj shkruhen edhe në dërrasë.

Ne thamë se gjeli e sqoi ate djalin nga gjumi. Po ky vetëm Petritin zgjon nga gjumi? A po zgjon edhe njerës të tjetër? Nx. . . . . E me të vërtetë gjeli nuk sqon vetëm njerëzit e një shtëpije, por gjithë njerëzit e një mëhale ose të një katundi, se pse zani i tij ndëgjohet shumë larg. Mirpo a e dini ju se ç'far bajnë njerëzit, kur e ndëgjojnë këtë herët në mëngjes? Nx. . . . .

M. po me të vërtetë njerëzit që deri atëhere ishin shtirimë; sikurse me qenë të vdekun, ngrihen e shkojnë në punë. Po ata njerës që janë të semundë ose pleqta a ngrihen këta kur ndëgjojnë gjelin herët në mëngjes? Nx. . . . . A shkojnë këto për punë? Nx. . . . .

M. Qysh mendoni ju kush ngrihet më herët në mëngjes? Nx. . . . . edhe me të qekuna prej mësuësit thonë për bujkun, gjithashtu edhe për njerës të tjetër. Mandej nx. tue u pyetur prej mësuësit kallzojnë edhe të ngritunit e njerzve ma herët në prandvere e në Vere se sa në dimërr, me të tjera fjalë kohën e punës.

Si të kallzohet mbrendija e vjershen në këtë mënyrë, atëhere paraqitet vjersha tue u këndue se pari e tanë 2 3 herë me gjallni, me theksimin e duhur e ngadalë prej mësuësit, masandaj u shpjegohen fjalët e vështira të copës, fjalë që munden me qenë të reja o e të pa kuptueshme prej nxansve.

Ushtrimi: Tani vjen të ndamit e vjershës në strofe dhe të mësuem it e të ushtruem it e sajë ne pjesë.

Merrin dy strofat e para të vjershës këndohen përmendsh 2 3 herë sikur thamë edhe ma sipër prej mësuësit; mandej e këndon bashkë me nxansit së pari me za më të ulët e pastaj me za pak më të naltë. Këndohen prej nx rrjeshta rrjeshta, banga-banga e më në fund disa prej nxansve më të mirë veç e veç.

Po në këtë mënyrë veprohet edhe për dy strofat e tjera.

Përmbledhja: Si të mësohet e gjithë vjersha, atëhere pjesat e ndame bashkohen e përsëriten

me qëllim qi të bahen prona e nxansve.

### Tabella e mësimi

#### Kanga e Gjelit

- 1) Katund e mëhallë!  
Kikiki-riki  
Erih koha m'u ngjallë,  
Vjen ërita më një
- 2) Kush n' t' shtrüeme mos t' ngelin,  
Kikiki-riki;  
Mos shani pra gjelin  
Se ndihet me mëzi.
- 3) Veç t' smënd e të mbetun  
Kukuku-ruku!  
Mund t' ngjasin me fjetun  
Gjithë tjerët i çoj ñ.
- 4) Çou bulk o zotni  
Kukuku ruku!  
Se motin qi ñ shkri  
S'e gjeni më ju . . .

G. Daju '33

## PLAN MËSIMI

dhañun në vendin e tretë t'ushitimitores

Thema : Vizatim

Landa : molla, dardha, rrushi, . . .

Paragatija — Ju e dini se bujku bën shumë punë në kohën e vjeshtës. Kush do të më thotë prej jush pra disa punë, qi bën bujku në këtë kohë? Nx: këthen arën, e plehnss tokën, pemët, etj. Mës: Me të vërtete bujku qysh tash kujdeset për pemët e iu bën disa shërbime atyne, kështu pi vitin e ardhëm të bëjnë më shumë.

A e dini ju se c' farë pemësh piqen tash në vjeshtë? Nx: . . . . . Ai keni pamë në pazar se çfarë pemësh kanë dalë? Nx: mollë, dardha rrush, shegë, ftoj etj. mës: A ua ka anda fort këto pemë? Nx: . . . . . Mës: me të vërtetë këto, veç qi janë të shishme me u-hangër, janë edhe të bukura me u-pamë. Prandaj, ndoshta ju keni pamë, se nëpër dhoma varin nanat mollë, dardha, shegë ose ndonji vesh rrush.

Tash po na vjen dimëni, e pemët do të na mbarohen. A do t' ju marrë malli më i pamë? Nx: . . . . . Mës: Shka duhet të bëjmë pra, qi t'i kujtojmë ato, sa herë të duem? Nx: Do t'i vizatojmë. Mës: Po pra, t'i vizatojmë, qi t'i kemi

n' ërmend gjithë!

Paragatija. | Mës: Më i tregoni dhe një herë pemët e vjeshtës? Nx: . . . . . Mës: u flet për një mollë e një dardhë dhe u thotë nx: të tregojnë shenjat qi i dallojnë njena prej t' jetrës: (dardha është ma e gjatë në krye e është me mënjë e jo si molla qi është me gropë; dardha bishitin e ka më të gjatë etj. Në këtë kohë, tue u përfolë pjesët e mollës, vizatohen ato prej njësi; e si të mbarohet së vizatuemi prej njësi: flitet objekti e urthnohen nx: të nxjerin flitoret me numrim e fillojnë të vizatojnë në bazë të fantazisë. Po kështu bahet dhe për dardhën. Pastaj mës: flet për shegën. i pyet nx: se si e ka formën, fundin majen dhe ngjyrën e lëkurës e pastaj e vizaton me ngjyra, mbassi ta vizatojë, e vizatojnë dhe nx: Kështu bahet dhe për rrushin, po të këtë kohë.

Në kohën kur mës: vizaton duhet t'i këtë sytë dhe ke nxanësit, qi të mas u dali mendja nga mësimi e të mos bëhet ndonji zhurmë. Dhe kur të vizatojnë nxanësit, mës. duhet të vërejë punën e tyre. Kështu qi tue përfolë me za t' ulët gabimin qi ka ndonjeni. të mundet me u bë puna llogjikisht.

Abas Xhafa '34

### RRETH E RROTULL BOTES.

Mosha e detyruar për shkollë dhe vijimi i saj.

Këtu poshtë po shënojmë një përmbledhje të detyrimit shkollor nëpër shtete, ose krahinat të ndryshme të shteteve të ñdhen t'one. Marrë nga Zyra ndërkombëtare e Edukatës për 47 shtete.

Që më 6 gjer më 13 vjet: Shqipëria, Franca, Luksemburgu. Që më 7 gjer më 13 vjet: Ekuatori, Panamaja. Që më 7 gjer më 12 vjet: Egypiti.

Që më 6 gjer më 14 vjet: Austria, Badi, Prusia, Belgjika, Dansigu, Iaspaña, Italia, Meksika, Irlanda e Veriut, Shtet' i lirë i Irlandës, Tchekoslovakia, Uruguai.

Që më 7 gjer më 14 vjet: Brazilia-Kanada (Manitoba), Danemarka, Haitia, Islanda, Nikaragua, Zelanda e re, Holanda, Pollonia, Dominiku, Rumania, Siami, Suedia, Jugosllavia.

Që më 5 gjer më 14 vjet: Anglia, Ekossa, Paraguai.

Që më 8 gjer më 14 vjet: Estonia, Finlanda. Që më 6 gjer më 15 vjet: Hungaria, Svicra (Cjenvë). Që më 7 gjer më 15 vjet: Kanada (Alberta, Kolombia) Shit.

Që më 6 gjer më 16 vjet: Bavaria, Që më 7 gjer më 16 vjet Shtetet e Bashkuarë (19 shtete) Letonia, Svicra (Vand), Që më 8 gjer më 15 vjet: Norvegjia.

Që më 8 gjer më 18 vjet: Lidhja e Republikane Sovietike.

Përmbledhur prej Masa.

# VEPRIMI I PUNES MBI KARAKTERIN.

Karakteri i njeriut edukohet më tepër me anën e punës. Puna është nana e bindjes, e përmbajtjes, e kujdesit dhe e vullnetit. Ajo e bën njeriun të zotnojë mjeshtërinë e vetë dhe bashkë me këtë e mëson si të mund të nxjerrin gjënat më të vlefshme e më të dobishme për jetën.

Shkrimtari Angles Samuel Smiles, në librin e tij (Një vehten t' ande) midis të tjerëve përmend edhe këto mbi punën: puna është ligji i rrojtes s' onë, është shtylla e hekurtë që sh'yn përpara njerzit e kombet. Të shumtët e njerësvet punojnë, që të muad të jetojnë, por se të gjithë pa përjashtim në qoftë se duen të ndjejnë kenaqesin e jetes, duket me doemos të punojnë; puna mund që është një barrë e rëndë por është nder e zulumë; pa punë kurrëgjë nuk mund të fitohet, qytetnimi e çdo gjë me rëndësi është pema e punës. Në qoftë se njerzit nuk do të punojshin, raca njerzore do të vuante prej vdekje morale.

Historia na tregon se Romanët e kishin për nder të math punën, edhe deri sa këjo që i vetmi mejtim i tyre Roma mbritni në kulmin por që kurse këjo u la mbas dore tue ia lëshue vën din Iluksit, Roma ra fare posht e për së shpejt erdhi dhe shkatërrimi.

Shkrimtari i famëshëm i Romës, Plini, tue përshkruar gjendjen shoqërore të Romës së herëshme thotë se ushtarë e gjeneralë tue u kthye të shëndoshë mbas fitimesh të shkelqyshme, rëndnin me gëzim, me marrë në dorë parmendën: «Dheu atëhere, thotë, lavrohesh prej duersh gjeneralësh dhe toka ishte kryenaltë, pse punohesh me parmenda të kuno rëzueme me dafina» Por që kurse puna u la në duer të skllavëve, tue u qejtë si gjë e poshtme për klasën aristokratë, që atëhere Romës i erdhi shkatërrimi.

Prej gjithë pafuqisivet të natyrës njerzore, ajo ma e keqja është papunësija, të cilën njeriu duhet ta luftoi me çdo mjet e mënyrë, pse poshtënon njerzit e kombet.

Përtacmija nuk mundet as me i kapërcyë, as me i luftue pengimet e jetës, fundi i saj është gjithmonë. Kudo e kurdoherë peripeti.

Vurto ai, shkrimtar i math i Anglis në veprën e tij «Anatomija e Melankolis» e quen përtac-

mënin si burimin kryesor të dëshpërimit e të melankolis, dhe thotë: «Përtesa është mundimi i shpirtit e i trupit, nana e çdo të keqe që ndodh në botë, praku e jestiku i djallit. Përtesa mendore është ma e keqe se ajo trupore, e sikurse n' ujnate e ndejtme shtohen e shumohen insektet e mikrobe të damëshme, po në këtë mënyrë mblidhen e shumohen mendimet e këqija në mendjen e nji njeriu përtac.»

Njerzit përtac qofshin burra e gra, të pasun, të vobegët nuk mundën me shijue lumtërinë e kësaj jete, e cila varet kryekëput nga veprimi puna e energjija.

Përtesa e dobson njerin, përkundrazi puna i jep shpirt fuqi, shëndet e lumtëni; e vërteti është që puna e lodhë mendjen e trupin, por pa punësija sjell dame shumë ma të mbëdha.

Nga çdo anë që të kthejmë syt kemi me pa pemët e punës. Gjithë hekurudhat që përshkojnë anë e mbi anë kontinentet, gjithë vaporet kollosa e që përçajnë dallgat gjigante t' oqeanëve, janë pjella të mëndjes puntore të njeriut.

Kanali i Suezit, është fryt i vullnetit të hekurit të Lessepsit; qimija është fryt i Lavoisier-it.

Prandaj në qoftë se dëshërojme të rrojmë të lumtun, duhet që i vetmi mendim i ynë të jetë puna, e cila pa dyshim do të na çojë n' udhën e mbarë: Çdo neri duhet të ketë parasysht se duhet ba nji punë, në qoftë se dëshëron t'a ndijë vehten në nji gjëndje të mirë. Duhet të dijme se fytyrat ideale, njerzit e pa vdekur si Edisson-i, Washington-i, Fulton-i, Pasteuri, Gutemberg-u, Kepler-i, Pascal-i, Newton e tjerë, i arrijtën qëllimit të tyre të shën të me anë të punës. Duhet të na mbushet mendja se asnji vepër nuk u mbarue pa punë, vetëm vullneti i bashkuem me dashunin mbi punën, qiti në dritë shtypëshkronjën, telegrafin, telefonin, qimin, fizikën e tjera.

Le të mos shkojmë larg, po le të kthejmë syt nga qeveritarët e udhëheqësit e shteteve të ndryshme, e kemi me pa se që të gjithë janë puntorë.

Në qoftë se dëshërojme, që të hymë në radhën e shteteve të përparueme, që ecin me hapa gjigante, duhet të ounojmë shumë ma tepër se ata, jemi nji shtet i ri e që t'ia arrijmë qëllimit t'onë, duhet të punojmë ma tepër se gjith kush, e

## “BESIMI I VET-VEHTES”.

S' ka gjë më të dobët në botë se sa të mos pasunit e ndjenjës së vetë vehtes, të mos njiçtu rit e vlerës së vehtes t'ënde. Të jesh i zoti e të mos kesh besim se je i zoti është një soj si të quhesh me emrin X . . . . e vetë të mos besojsh se je X—i. Njeriu, sado i ditur qoftë, po s' pati besim në diturin, që ka fituar, atëhere është një soj me atë njeri që s' ka fituar fare.

Merni-e me mënd se në ç' farë gjendje kishte për të qënë bota mbarë, në ç' gjendje kishte për të qënë përparimi i sotshëm, në qoftë se njeriu nuk kishte besim në vehten e vet, gjykoni nji copë herë se ç' vleftë do të kishte njeriu vetë në qoftë se nuk e ndjente vehten të zotin për ç' do punë meadore e trupore. Pa tjetër bota do të ishte një asgjë dhe njeriu do të ishte një e qenme e kotë e ksaj bote asgjejeje, kurse përparimi i sotshëm do të ishte mbyllur në zeron e jetës! E atëhere do të jetonim si të qenme të hedhura pa kuptim në këtë botë.

Pra besimi i vet-vehtes është gjëja më e çmuarë, që duhet t'a ketë ç' do njeri, pse, po e pati këtë, është më i dituri e më i zoti i tërë botës. Sa për shëmbël at le t'i marrim nga jeta e jonë e përditëshme pa shkuarë fort larg në gjëra që vetëm mendja e fortë mund t'i kuptojë. Shikoni: ndërmjet nesh gjenden asij njerzish të cilët me gjithë që e dinë një gjë, nuk e bëjnë nga frika se mos i përbuzë bota. Po e marr si shëmbull vehten t' ime: para disa vjetve profesori i gjuhës na kishte dhënë një hartim për të zhvilluar, mirëpo unë, me gjithë që më ipnin zemër shoqet e mija, nga mos pasia besim në vet-vehte, e lashë hartimin pa e bërë të thuash 3-4 ditë, deri sa u shtrëngova t'a bëj nga nota e profesorit, po fundi doli fare i mirë, veçse . . . . humba 4 ditë! E gjatë këtyre katër ditëve nëpër mëndjen t' ime vinin e shkollin pyetje pa kripë e pa themel: Vallë a nuk është frikë se mos shkruaj tjetër për tjetër?

pa dyshim puna do të na shpërblejë.

Prandaj edukatori dhe prindi duhet t'u apin fëmive shembella të mira të punës, e të mbjellin në zemër të tyre zell e dashuni për t'ë.

A. Andriku '33.

Vallë a mos bëhem gazi i botës me mendimet e mija? etj. etj.

T'a njofish vlerën e vehtes t' ënde nuk është një padrejtësi. Padrejtësi është kur je i zoti dhe zotësinë t' ënde e len mbas dore, kurse vetë dukesh si budalla. Duhet t'a dimë se vetëm me të njoiturit e vlerës së vet-vehtes kaqe njerës kanë marrë rërsipër punë të rënda e kanë bërë gjëra të çuditëshme dhe të dobishme, që i shijojmë sot aqë bukur.

Por është padrejtësi kur kujton njeriu se është diçka më tepër se sa është me të vërtetë. Kjo është krenari, kotësi. Kështu shumë njerës e pandehin vehten e tyre se nuk kanë të meta prandaj u pëlqen që të kritikojnë botën dhe përpiqen që të mësojnë të mirat, por më fort të metat e tyre. Kjo shifet, më tepër kur mbledhen disa njerëz, sidomos femërat, më ndonjë bashkë fjalim, zënë e kritikojnë njerën që s'e kanë aty dhe thonë për të ç' dinë e ç' nuk dinë, por më fort të metat. Këto sikur të marrin për pasqyrë vehten e tyre e t'i njohin të mirat dhe të metat po të tyre, atëhere do të kuptojnë se sa e rëndë është që t'a mbash tjetrën nëpër gojë.

Por është edhe një gjë fort e vështirë që t'i a çmojsh vlerën vehtes t' ënde, është një gjë fort e rëndë të mbesojsh se je ai ose ajo që je e ti bëjsh të tjerët që të të nderojnë për atë vlerë që ke. Porse edhe është gjëja më me rëndësi të njofish vet vehten, aq sa që të vjetërit e kishin për gjë të madhe dhe medje e shkrojtën edhe në portën e Oraklit.

«Njih vehten». Detyra pra e arsimites, dhe e arsimtarit është që të përgatitë një brumë të-mijësh që të qëndrojnë ndërmjet kryetësisë së pakufi dhe të kotësisë; të bëjë një brum njerëzish të cilët të dinë t'a çmojnë vehten e tyre d. m. th. të dinë se ç' dinë e të besojnë se ç' do ditë fitojnë dituri dhe bëjnë diçka të re. Vetëm me të tillë fëmijë, që në të nesërmen pa tjetër do të formojnë ajkën shoqërore, do të shkojnë mirë e bukur gjithë punët shtetnore.

Ruhije Buda '33

## NOVELË

## NE VETMIN E FSHATIT TE QETE

Muaj i Shënëndreut . . . . Natyra kudo def-tohej e zveshur nga çdo shenj gjallërie.

Pisku i dimrit. Veriu i thatë përplasej si i tërbuarë mbi çdo gje që gjente përpara. Dëborë e madhe kishte zenë e prapë binte . . . . Tufan dukej në të gjith anët . . . . Fusha e male ishin mbuluarë me dëborë . . . .

Ditë pushimi, në të cilën, Mësonjësi djaloshar, kishte vendosur të mbaronte detyrët e nxënës-vet. Ndes porin dhe vete në tryezë, hap fletoren e parë, por pa dashur zhytet n' oqeanin e mejtimeve të së shkuarës kaqë sa e humbet fillimin e punës; fsheh kryet në mest të dy duarvet dhe mejtohet për një copë herë . . . .

Përfytyrime të ndryshme i shkojnë nëpër mendje si filmet e cinemasë. Ngre kryet, heth një vështrim të rëndë rreth e rrotull dhe verën në dritare, ngrihet me zemër të vlerosur dhe qaset pas saj.

Sheh botën e jashtme, ku s' pipëitinte tjetër gjë veçse shtëllungavet të dëborës, që përplaseshin pas murit prej veriu me aqë egërsi.

Sheh dëborën, por mendjen e ka në të shkuarën, të cilën e sjell në mend së bashku me ato mënda të lumtura që kishte shkuarë me Lilinë, me atë që i kishte hyrë aqë shumë në zemër.

E përfytyronte fund e krej, e stoliste edhe aqë më tepër me fantazin e tij: ishte trëndafil pa gjemba.

Kishte mjaft kohë që ishte larguar nga vështrimi i saj, po vinte moti rrotull, prandaj dyshonte se mos e kishte harruarë. I vinin në mend, si zinxhir njëra pas tjetrës fjalët e ëmbla që kishin rrjedhur prej gojës së saj si edhe zotimet e dhënë, por tashi s'i mbushej mendja; munt ta kishte harruarë.

I gjori djalosh, që nëmëronte të-21-tën pranverë, tashi ishte lark, shumë lark nga Lilija dhe s' kishte se si ta provonte.

Këta mejtime i kishin zaplakosur zemrën Mësonjësit dhe rendonin mi jetën e tij të ujomë

e ca më tepër i shtoheshin kur sillte në mend se në vetmi po shuante ditët e djalëris në një fshat të shkretët.

Përnjëhëre e përmbloodhi vehten, zgjohet nga lethargjia e tij e kujton që të nesërmen gëdhidhej e hënë e kishte postë e vendos që t'i shkruajë. I tronditur por edhe i çkujdesur unjet në tryezë, mbleth fletoret e nxënësve, dreth cigaren, merr letër e pendë e illon të shkruajë:

Lili e dashur!

"Lark syve pra edhe lark zemrës, ka thënë plaku i moçëm, por a duhej t' ishte e vërtetë edhe për ne? Sa për nga ana e ime s' do ta pranonje me es një mënyrë . . . .

Të kam dhënë fjalën dhe aty do të qëndroj gjersa të më regëtitjë edhe ajo më e fundit pikë gjaku nepër remat e trupit t' im.

Të kam dashur dhe do të të dua. . . .

Këtu në qetësin e fshatit por edhe në vetmin e paduruarë a e kujton se sa në mërzitje rroj? Jam i larguarë nga çdo shoqërim i fshatarëvevet e vetëm shpirti i yt më përcjell çdo orë e çast. Shkruajmë, shkruajmë, në ke mëshirë, qoftë edhe një fjalë e vetme se të jesh më se e sigurtë që ka për të qene shumë për shpirtin t' im kaqë të brengosur.

Dyke shpresuarë që ke për ta mbajtur zotimin e dhënë një herë, po e mbyll këtë letrë».

Nga sytë e venitur të djaloshit rrihnin pa reshtur lotë; le pendën më një anë, palos letrën se s' kishte fuqi ta vijonte, e mbylli në pliko dhe të nesërmen e dërgon në postë me rojtësit e fshatit.

S' ishte mbushur edhe pesë ditë kur letra këthehet me një anëshkim, që thotë:

"Drapëri i pamëshirëshëm i vdekjes, pas 13 ditsh lëngimi, rrëmbeu nga gjiri i ynë driten e syve t' onë. Prindi i së ndjerës . . . .

B. Zhudi '29

# DJELMËNIA

Djelmëni! asht një emën i hovshëm, emën fantastik dhe plot respekt për pleqt edhe uzdaja ma e bukur e atdheut. Po! . . . ashtu asht, por djelmënia nuk duhet të tregohet e pazotë për këtë nder, që po i bahet nga parashkuesit e 'saj, nga brezi i mplakun.

Kështu kanë thanë të dituni, kështu po thotë edhe arsyeya e çdo njeriut: Djelmënia asht shpresa e bardhë e çdo kombi. Kjo asht një emën që i vishet me gjithë zemër dhe me plot arsye djelmënis së çdo vendi.

Asht si parimi i pakundërshtuem se djelmënia quhet shpresa ma e bukur e kombit, sepse ajo nesër ka me marrë frenat e shtetit në dorë edhe ka me u-ba ushtari, mësuesi, gjykatësi, financieri, diplomati etj. i kombit. E ardhshëmja pra nuk asht e brezit të sotshëm, e brezit, që po perëndon, por asht e djelmënis. Lumnia e ardhshme e atdheut varet nga djelmënia; mbarëvajtjen, lulëzimin në çdo gja edhe përparimin e ardhshëm e ka monopolizue ajo dhe as një t' tjetër. Prandaj asht shpresa, shpirti, mendja dhe krahu i kombit.

Por lumnin e ardhshme nuk e siguron aspak një djelmëni me shpresë të zbetë, me mendje të mplakun, me zemër të keqe e me krahe të dobëta. Të gdhësh tue thanë se jam dishka e mund të baj dishka dhe të ngryshesh pa oamë asgja të mos të mbetet kohë me hangër as drekën nga shkopi i bilardos e nga pllakat e dominos; dita ditës me e zbras xhëpin e me e mvrëjtun fytyrën pse nuk të vajti puna mbarë në letrat e kumarit; të bajsh ub e ah pse atë ditë të paska shpëtue nga duert një zyzezë edhe të mendojsh or e çast se qysh me e ndrequn kravatën e ilokëti dhe në ç' mënyrë me imitue Ramon Novaron a Valentinon: kjo don me thanë me u lindun me mend ndër kambë a një domethanje t' jetër—me qenë i penduem pse ke pa dritën e kësaj botë! Të rrijt e tillë as kanë pse me i quajtun njerës, e shpresë, mendje, e zemër e krahe. Vetëm një djelmëni e pajosun me shpresë të shkelqyeshme, me mendje të shkathët tejet me shpirtëngjelluer edhe me krahe të fuqishme, vetëm një e tillë me cilësi të tilla asht e zoja për me sigurue lumnin e ardhshme t' atdheut, asht e zoja për me formue një brez të qytetnu-

em, një shtet të vërtetë. Vetëm prej kësaj djelmënie pret populli përmirësimin e vet, shteti pret shërbime ma të mbëdhja.

Por qysh mund të bahet djelmënia një shërbëtor besnik dhe i vlefshëm për popullin? Qe një pyetje e gjatë, por don një përgjigje të shkurtër: Vetëm me anën e edukatës. Pra vetëm djelmënia e edukueme asht shpirti e mendja e kombit, kurse ajo e paedukuemja e edukuemja keq asht mynzyra, fal-keqësia dhe humbja e 'tij. Për këtë gja djelmënia duhet të përgatitet, që, kur ta marrë barrën përsipër, të jetë gatë për punë, për veprim. Por qysh të përgatitet, qysh t' edukohet?

Së pari zemra e të riut duhet të jetë mbushun me entuziazëm. Entuziazmi asht fuqja dhe shëndeti i mendjes—ka thanë një i ditshëm. E me të vërtetë jeta e njeriut quhet se gjindet deri sa jeton tek ai entuziazmi. Po qe se vdes entuziazmi, vdes edhe njeriu mendërisht, me gjithë që ndoshta ka me jetue trupnëisht. As një qëllimi nuk mundemi për me ia mërijtë pa pasun entuziazëm. Çdo punë, që po na dorëzohet, duhet ta mbarojmë me entuziazëm. Vetëm ky asht misteri i vërtetë i fitimit. Të gjithë ne po shkojmë për mes një udhe përparimtare udhëheqësi i së cilës asht entuziazmi, prandaj kur marim përsipër një punë nuk duhet të na trembin pengesat e udhës. Më një kohë të mvrëjtun me re, edhe sikur të mos e shofim diëllin, në dymë se ai shkëlqen, por vetëm duhet të shpërndahen retë, që ta shofim dritën e 'tij të shkëlqyeshme. Kjo ngjan edhe me punën e vështirë, që ruan me vehte edhe entuziazmin, çelsin e vërtetë, që i ngren njerëzit nalt.

Pastaj duhet të ketë të shkrueme në ball dhe në dëshirë të vet fjalët vepruese: punë dhe përpara; mandej duhet të formojë besimin në vehten e vet se asht i zoti. Jam i zoti dhe do ta baj: ky duhet të jetë vendimi i të riut për punën e paramendueme. S' duhen dredhina, s' duhen fjalë të tepërta. I riu, që ka besim në vehten e vet, nuk pret inisiativa nga jashta, por ai vet asht inisiator, veprues. Pra vetëm një djelmëni, qi flet pak dhe që punon shumë vetëm kjo asht tue u-përgatitum me gjithë mend.

Deri sa asht në shkollë me gjithë mend duhet

# ZOJUSHA E QYTETNUEME ME CINGARE NE GOJE!

... Asht 13 Shtator edhe automobili vullon nëpër rrugën Korçë-Gjinokastrë Kali pa shpirt asht vigan dhe veç ngarkesës së ran-

të jetë nrxanës. Ka me qenë i tillë po qe se i studijon me rregull mësimet, ndigjon të parët edhe sillet për bukuri me botën e jashtme. Nrxanës don me thanë me qenë në marrëdhanye me mësimet e shkollës e me jetën e jashtme. Disiplina, qi asht arma më e sigurtë e përparimit, të riut duhet t'i ngulitet qysh në shkollë; të ndihmuemit e t' afërmit duhet me kohë t'i jetë ba shprehë. Por edhe mbassi largohet nga bankat, duhet të jetë po nrxanës, d m th. duhet të studijojë gjithënjë, që të pasunohet me dijë të gjithëmarshëme e të d' bishme. Duhet të mësohet që të mendojë drejt, të gjykojë arsyeshëm edhe gjithmonë të qendrojë me syt të drejtuem kah ideali, që duhet të ndjekë. I rin në çdo punë duhet të përgatitet: vërtet të jetë i zoti të shkruajë me kalemin e z', por të jetë i zoti edhe të punojë me kazmë. Duhet me pasun rregull edhe në punë. S' ka gja ma të keqe se me punue pa rregull, pa drejtim, pa qëllim. S' ka marri ma të madhe se sa me punue, me fjetë edhe me u-argëtue simbas së tekmes e jo mbas arsyes. Djelmëni e parregulltë don me thanë djelmëni e mplakun. e vyshkun tejet.

E tashti kur djelmënia e shef se asht e pa-isun me këto cilësi, vjen detyra e 'saj. Këtë detyrë na e shpjegojnë shumë bukur fjalët e mbretit t' urtë të Finlandës, Snelmanit të parë, i cili me këto fjalë këshilloste djelmënin e ve: «Intelektual nuk don me thanë të veshis rrobe të modës, kapello të kohës dhe kravatë që shkëlqen. Pjesa intelektuale asht si truni i një populli Kombi nuk ju mësoi për me marrun rrogë të majme dhe për me u-argëtue nëpër kafeanet tue luejtun letra e domino. Të gjithë të ditunit e kanë për detyrë të përpiqen për naltësimin e arsimit Kombëtar, për me zgjue ndërgjegjin kombëtarë edhe për me formue vullnetin kombtar. U mësoni fsbatarëve, punëtorëve dhe klasavë të vorfna të qyteteve një mënyrë të mirë për me jetue.»

Stespa '32.

dë, përpara, si në qafë, mban kaluem edhe nantë njerës, ndërmjet të cilëve gjinden edhe dy femna. Kullën e Qarit e lemë pas dhe rerdim tutje për në Koloajë. Dy femnat: zojushen X. dhe t' tjetrën i kam përpara meje. Njëra ajo që nxjerr pa da nga barku gjellët e Korçës, nuk ka kohë me u-marrë aq fort me dokrra shoferiane por zojusha X., tue qenë ende në t'ë, dridhet e përdridhet! Por me thanë të drejtën unë s' i-tuta as nga këpucët e 'saj të bardha, as nga çorapet e mëndafshta, as nga fustani ngjyë-qjelli i mbyllët, as nga palltoja ngjyrë-kafeje e qendisun me lëkurë dhelpere as nga bereja e kuqe dhe as nga thonjt e gjata të gjishtave të vogla; jo! s' u tuta se këto dhurara evropjane të përcipta janë moda e kohës s' onë; asht ironia e jetës! Veçse, . . . ç' po them? . . . Rrotat e automobilit rrotullohen pa da nëpër të këthymet e Qarit dhe shoferi, ven buzën në gas dhe hedh syt në të katër anët dhe qesh me zojushen! Nuk shkoi ma gjatë;

— Urdhër ni nga nii cingare, zojushe! — H pa syt ma mirë: ishte zani i shoferit, i cili me një-nen dorë po u afronte femnave nga një cingare. Ja edhe politesë shoferiane! Ja edhe kulmi i qytetnimit!

Mpihem dhe shikoj: zojusha pa një pa dy e rrëmbeu cingaren, e ndezi prej dorës së shoferit dhe . . . paf-paf! tymi po dilte nga goja e vashërisë! Kësaj here, me thanë të drejtën, u-tuta, medië u-tuta keq!

— Fbiu, fbiu, fbiu! Ma hani në vesh një i shkuem nga mosha, që e kishjem për brij. A shikon se ka bukur po na drejttoni ju të rijt? I Lum se, lum edhe ju.—mandej si nëpër dhambë shtoi:—Lumi që na mori!

Këto fjalë sarkastike të plakut m'u dukën si shpulla të nxehta të dhanuna mbi faqet e mi-ja për fain e tjetrit. Kjo gja ma shtoi dëshpërimin edhe më: E verejshem Zojushen përpara meje me cingaren në gojë, që po e shtrëngonte edhe ndërmjet dy gjishtave, e me atë qendresë dredharake dukej sikur donte me i dalë për shëmër Brigides Helm. Por, o fat: Brigides Helm në Hooliwood, kurse kjo ndërmjet frenave të shoferit! Kjo ndoshta e ledhatonte vehten pak edhe ndryshe: Sa e bukur dukem kështu me

cingare në gojë e dhurueme prej . . . shoferit! —mendonte Zojusha e qytetnueme njëzet-vjetëshe dhe dukej e lumtun ndërmjet atij rrethi burrash, që s' dinin se ç' asht moda edhe se si mbahej me naze cingareja në gojë!

Me gjithë që Zojusha njëzet-vjetëshe që asht dhe Zojushë e qytetnueme(?) — nuk e lishoj cingaren nga goja pa iu djegë buzët, përsëri kujtoj se ajo nuk do ta pijë duhanin rregullisht, por —hajt, njeri! —nji tekë mjafton për me u ba modë ndër të cekëtit dhe ndër të cekëtit t' ona!

Unë qendroshem ende si i hutuem, kurse plakun vijonte shpotin për fain e pafalun të Zoju sësh së qytetnueme:

—A thue kjo asht sheja e qytetnis: me dijtë me ndenjün kambë mbi kambë përpara të parëve, me pimë duhan, me vallzue allafrangë, me qitë të zgjatme pas fustanit si bisht larëske, me përdorun pudrën evropjane në surat, të kuq e bojxhiut në buzë, me u-përdre lhtë përpara botës, me mbushë barkun me birrë amerikane dhe me, . . . dhe me—oh, marri rinije!—dhe me . . . ba ç' gja që nuk jasht për t' u-ba? . . . S' keni drejtim, s' dini se ç' bani! Fiisni shumë por s' bani gja! . . . Vajzë me cingare në gojë ë? ! Dhe me pimë përpara botës ë? ! . . . Dhe me e marrë nga shoferi ë, . . . dhe me e ba këtë larg, n' udhëtim ë? ! . . . Ua, po shkoni anë mbrraptas, Zoiëni i ri; kështu nuk do të bani as nji çap përpara, nuk do të formoni dot aspak edukatën thjeshtë kombtare. Ne shkuam, por ju të rrijt me këtë mendje keni me mbetun pa 'rekë'! Kaq dhe pushoi i shkuemi nga moshja, lëvizti pak nga vendi, u-koll dhe me urretje, ia nguli syt zojushes, e cila porsa mbaroi Kangën e Mukës!

Pushoi plaku, mbaroi cingaren edhe e reja, dhe ndashti po . . . e lëshoj kalemin edhe unë tue bamë vetëm nji pyetja ma fort për Zojushen e qytetnueme, që na dha shëmbëllën e bukur mbrenda në këthinën e automobilin:

«A nuk më thue, o Zojushë me cingare në gojë, vasha e qytetnueme shqiptare nana e nesërme e kësaj race, a duhet me qenë me gjithë mend Zojushë, grue, njeri, apo me u zhytun nëpër marinat e qytetnimit të sypërfaqësëm, të rremë? »

.St. Spase. '32.

## LAMTUMIRË NJË SHOKUT TË HUMBUR.

Në një kodër të bukur, lark, shumë lark Bllishtit, dhe në verilindje të 'tij, në një vent si të shkretët, ku njeriut s'i bie udha të shkojë, veç se me qëllim, gjinden varret e katundit të Verninikut, në të cilat dergjet një trup i vyer i shkollës s' onë, trupi i të ndyerit Vasil Muzhofit '34, dhe në këmbë të kësaj kodre të qetë përmbli-dhen godinat e katundit.

Për këtu pra, një trumë nxënësish, ose më mirë të them, edukatorësh të rinj, po bisedojnë të vijnë; janë rendi i fundit i shkollës Normale t' Elbasanit, të cilët qëllimin e 'tyre që kishin të shëtitin Shqipërinë, thuaj se po e mbarojnë; kanë mbijtur në Korçë, dhe këtu s'u mbetet t'jetër, pa të shpërndahen, veç se t'i thonë lam-mirë edhe një shokut të 'tyre, i cili i këputur prej drapërit të pamëshirëshmë të vdekjes, s' mundi të gëzojë dot bashkë me shokët e 'tij këto ditët e fundit të jetës së përbashkët të ka-qe vjeteve, të jetës shkollore.

\*\*

Fh . . . . shkojmë ? . . .

Po . . . do të shkojmë t'i themi lamtumirë edhe atij që s'mundi të na shoqërojë... shkojmë. dhe shkova dhe unë bashkë me 'ta.

Po ç' t'ishpjëmë që të na njohë se jemi shokët e tij?

. . . . Një kurorë lulësh, q'e thurrmë n' agimin e ditës. Kjo ishte ajo që shpumë, e, s' ka gjë më. Por kjo s' është një lamtumirë e fundit, veç se një përshëndetje e përbashkët, ose një lamtumirë e jetës shkollore.

\*\*

Edhe shkuam. Sikurse syt' e jona, ashtu edhe qielli me të pahir i mbante lotet e tij. Ishte nji mëngjes me gjysmë Diellë, dhe ne po prisnim nën hijen e disa plepavë dhe pranë një krojt njerëzit e të ndyerit shokut t' onë.

Katundi dukej si një katund bujqësor, se edhe njerëzit e tij ishin shpërndarë nëpër arat, dhe po nër ara kishin shkuar dhe shtëpia e Vasilit.

Ë' shkoi shumë, dhe njerëzit, që prisnim na ardhë.

# ERE TRENDAFILI NGA SHQIPNIA

Shënime nga radhoi i kujtimeve

## Fortesa e Tepelenës: një fantazmë e shekullit!

... Po hymë në grykën madhështore të Këlcyrës. Afrohemi te ura e Muço Yços dhe ndalemi një copë herë për me shikue mjeshtërin e kësaj ure bashkë me natyrën e atyshme. E bukur, e kandëshme, rrëpinsinë, e freshkët duket kjo natyrë, e ura, kur kalon nëpër të, hidhet si llastik i frymun deri sa të kalojë! Mbassi pimë nga një ujë të ftohtë, niseimi, nise-

mi tutje nëpër grykë, e cila or' e çast po na çfaqet ma madhështore: Malet e nalta dhe shkambore, rrëpinsinat e mprefta dhe të frikëshme Vijosa në për buzat me shtresat e shumta prej guri dhe me shushurinën e qetë të 'saj, qielli këthjellët dhe në trajtë rypi edhe anët e zgjatme tepër dhe të ngushta tejet na e bajnë me gjithë mend të kandëshëm udhëtimin t' onë. Gadi e gjithë gryka asht e ngushtë dhe e thellë shumë, edhe rrallë aty këtu shofim nga ndonji copë vend të punuëm. S' pamë kund në Shqipni grykë ma të trikëshme e ma madhështore se kjo e Këlcyrës. Të zhytun ndërmjet pamjeve të ndryshme, ndërmjet rrëpinsinave e shqembeve pa fund hymë në fushën e Tepelenës, edhe prej eë largu shofim vënd-lindjen e të madhit pasha të Janinës bashkë me fortesën e 'tij. Për një copë herë mendja e jonë shkoi 120 vjet pas, te koha e sundimit të Ali Pasha Tepelenasi, edhe syt po e soditën pamjen e bukur, që po na shtrihet përpara.

Të shkretët! Një motre, një baba dhe një nip. Me ç' zemër na shëkonin!

Në një anë gëzoheshin, te shëkonin gjith atë grumbull djelmoshash, që s' harruan detyrën shoqërore, dhe n' tjetër anë u digjej zemra, se gjith ky grumbull ua lëndonte plagën, që porse u kish filluar sikur t'u mbyllej.

Ky është baba i 'tij? pyet njëri. Po ky; i raskapitur, i drobitur, i krusur dhe i zbardhur jo prej kohës, por prej mjerrimeve që të sjell kjo mbi kokë.

Na u afruan pra, dhe na puthnë që të gjithëve në ballë, dhe çdo puthje për ne, si kurse për ata, na sillte ndër ment sa e sa kujtime t humbura.

Muarmë kurorën, dhe të gjithë së bashku iu ngjitëm lëdrës; hapmë një portë druri dhe hymë mbren a. Të gjithë si kurse t'e dinim, iu drejtuam një varri. Po doemos, si s' u gjetka se ku është vëndi i një trëndafili që shpërndan erë nga të katër anët?

Disa lule të vyshkura prej kohës, rreth një kryqi të drunjte të gjatë ishin në krye të këtij varri të math.

Prej këtu, si derdhmë n' a dy pika loti, se goja s' ish e zonja të fliste, me kokë t' unjur dhe pa bërë fjalë, por gjith se i cili duke blajtur mendime të ndryshme në trû të vet, shkuam

mi tutje nëpër grykë, e cila or' e çast po na çfaqet ma madhështore: Malet e nalta dhe shkambore, rrëpinsinat e mprefta dhe të frikëshme Vijosa në për buzat me shtresat e shumta prej guri dhe me shushurinën e qetë të 'saj, qielli këthjellët dhe në trajtë rypi edhe anët e zgjatme tepër dhe të ngushta tejet na e bajnë me gjithë mend të kandëshëm udhëtimin t' onë. Gadi e gjithë gryka asht e ngushtë dhe e thellë shumë, edhe rrallë aty këtu shofim nga ndonji copë vend të punuëm. S' pamë kund në Shqipni grykë ma të trikëshme e ma madhështore se kjo e Këlcyrës. Të zhytun ndërmjet pamjeve të ndryshme, ndërmjet rrëpinsinave e shqembeve pa fund hymë në fushën e Tepelenës, edhe prej eë largu shofim vënd-lindjen e të madhit pasha të Janinës bashkë me fortesën e 'tij. Për një copë herë mendja e jonë shkoi 120 vjet pas, te koha e sundimit të Ali Pasha Tepelenasi, edhe syt po e soditën pamjen e bukur, që po na shtrihet përpara.

Automobili, mbassi shpëtoi nga ngushtica e Këlcyrës, po ecën me shpejtësi dhe për pak minutash u gjindëm në buzë të lumit Drin. Këtu bashkë me automobilin — udhëtim i çuditëshëm! — hypim mbi një lundrë binjake, dhe lundërtarët, me anën e disa telave të lidhuna tej e përtej lumit, e banin lundrën-binjake të notojë

për në shtëpi. Këtu një kafe e hidhur qe rasti i fundit të mendojmë se po neverisim një shok.

\*\*

Edhe ikmë.

Lamtumirë o shok i dashur, ne, e në mos t' jetër kush shkolla e jonë, si për nxënës të mirë që të ka pasur, s'ka për të të harruar kurrë.

Llamb Durrulli '35

mbi ujnat e lumit si kafshë e ngordhun! Mbass: kapërxejmë lumin, i hypim së dytit automobilit dhe kalojmë nën fortesën mbi një rrugë të përpjetme e, tue lanë mbrë të djathtë rrugën e Vlonës, këthehemi e hyjmë në Tepelenë.

T' artuem për bukë, futemi në një gjellëtoze. Gjellbamësit gjellat i ishin mbarue, prandaj na jep ashure, ve të fërgueme edhe kos. Por shqip-pot, kur gjejnë, dijnë edhe me fitue: gjellbamësi, kur na pa aq shumë, me një herë nëpër radaken e 'tij i shkoj fitimi, edhe fët-e-fët e përgjysmoi kosin, ashuren edhe vetë por... çmimin jo! Po!... i mëncëm ishte: dy për një; mirpo nuk dinte, i shkretë, se në ishim këlyshet e shqipove edhe si të tillë, pa tjetër, kemi trashëgoue vetet e 'tyne! Me gjithë atë e kuptoi, por mbassi i u-ba ashëri-neshëri hesapi bashkë me mëndjen e 'tij të zgjueme!

Dalim për me e pamë kështjellën e tigrin të Shqipnis, Ali Pashajt. Hyjmë në për një derë nga ana lindore. Muret janë shumë të naltë edhe janë ba aq mirë sa që duken si me qenë prej çimentoje. Kush' e din se sa vjete kanë me kalue kështu në heshtje për me u-rrëmue këta mure nga natyra. Futemi nën kubet e murit të portës së jashtme: mjeshteri e çuditëshme! Kuboja e zgjatme dhe e naltësime sipër kokës s' onë, disa shkalla për t' u ngjitem në istikamin e sipërme në rast rreziku edhe vendi i siguruem i rojës së përditëshme dallohen për bukur. Nëpër një derë të dytë hyjmë mbrenda n' obor. Shkulli s' ka lanë gja më këmbë! Shkojmë disa çape ma tutje e zemë t' u ngjitemi mureve të kështjellës. Nën këmbët kemi një bodrum t' errët e i naltë sa të mund t' eci njeriu pak i përkulun. Hypim sipër: edhe këtu duket sikur ka pasë istikam për rojat, që përdoreshin në rast rreziku. Roja armën e vinte mbi një të çame dritareje, që asht pëmbrenda e gjanë, kurse nga jashta si plasë. Jemi nga ana e lumit: zgjatim kryet e shofim tërposhtë të kështjellës: asht shumë e naltë kjo pjesë e kështjellës edhe ka mjaft rrëpinsina nga fundi, sa që, kur i shef mendja të vjen rrotull. E ndashti mendo, njeri, se sa shpirtna kanë pa dritën e fundit të kësaj bote në ngrëfjen e kësaj fortese edhe se sa kufoma janë tretun nën shqembat e këtyne mureve për të plotësue dëshirën e njëj pashaj të kohës!

Syt po na shkojnë ma tutje: ja atje pak ma

larg mbi lum duken shtyllat e trasha shekullore t'urës së pashaj, që sot naltësohen lakuriq vetëm e vetëm për me dëshmue fuqin e Aliut. Shkojmë edhe rreth kështjellës: prej këtu Tepelena duket disi e bukur e një pjesë prej 'saj ka zanë vend n' obor të fortesës. Zbrisim nga muret e dalim te një derë tjetër nga ana e lumit. E verejmë me kujdes: së pari ka dy bodrume e mandej dy të ndame. Ndoshta këto kanë qenë për kuajt e Aliut(?). Pastajvien një e zgjatme dhe pas asaj dera e jashtme. Dalim jashtë dhe i hedhim syt nalt te porta: mbi një rasë shofim të shkrueme greqisht edhe turqisht këto fjale: «Vezir Ali Pasha». Kishite datën turqisht 1234 edhe greqisht 1819. Ndonji mbi-shkrim tjetër gjatë fortesës nuk gjejmë. Hyjmë përsëri n' obor. Nga mezi i oborit shofim gërmadhat e disa ndërtesave edhe shenjat e të ndamit të dhomave. Për këto, na thonë, se ishin banesat e pashaj dhe pak ma tutje ato të harremit... Po shkelim pa drojë mbi këto mbeturina të saraveitë Vezirit të math edhe sjellim ndërmend kohën e 'tij: Ja atje mbi një kand të dhomës nën qilimet e kushtushme indiane, i mbështetur mbi jasteke të mëndafshta, i veshun kushtuëshëm me rrobe të qendisuna edhe me fyturë të mvrejtun, gadi për t' u hedhun në grykë kundrështarit, qendron i randë Ali pasha tue mbajtur në gojë çibukun një metër dhe tue i shkue nëpër gjishtë me krenari egërsie tespiat xhevairë të lindjes! Duket sikur don për me na pritun si rrobën të 'tij shekullorë! Por... dale: Ai qendronte dikur ashtu, por sot ma nuk asht. Luani Ali Pasha asht shdukun, por jeton vetëm hija e 'tij e randë, jetojnë vetëm kujtimet e 'tij! Këtu, ku, para një shekulli e ca, pa lejën e Vezirit, nuk hynte as zog, sot ne shkelim pa frikë vetëm tue pasun përpara hijen e 'tij të randë, që ka me jetue për shumë qindra vjetësh.

Po i bijmë rreth'e rrotull kështjellës edhe kudo shofim mure e gërmadha, bodrume e oxhaqe të naltësime gjatë mureve; tek e mbramja e lemë fortesën ashtu sikundër ishte për me u dëshmue bresnive t'ardhëshme trimënit edhe punët e të parëve t' onë.

... E ndashti ti, o arkeolog dhe historian shqipëtar, a thue ke me mundun me mashë operatori me zbulue një nga një veprat qind-vjetëshe të tigrin t' onë, që prehej këndëshëm nëpër këto anë, a po a thue se ende kemi me shkue

# TE PERKOHESHMES "NORMALISTI"

## ELBASAN

Dole prapë?!... Apo ma mirë të them siç më thanë shokët, kur ua nxorra përpara Normalistin.

«Dalka prapë?!...»

— Po, doli: merr-e dhe nxir dhjetë lekët!

— C'më lypset?!

— Si s'të lypset?! Këtë e nxjerrin shokët t'ojnë, Mëma jonë asht për në!

— Mirë thanëm, po Llazari e përsëriti vetëm një herë ngjalljen dhe vdekjen e tij; E revista e jonë po vdes dhe ngjallet sa herë t'i tekjet!

— Asht faj i jonë, pse ne nuk ia dërgojmë pajtimet me rregull.

— Po ku të hjek zemra t'ia dërgosh pajtimin me rregull, kurse, si të marrish numrin e parë nuk je i sigurtë se po në këtë mënyrë ke për të marrë edhe të dytin?

— Shiko këndej, ma prit shoku t'jetër, revista e jonë, veç qi nuk del me rregull, por asht edhe gjysmake, vetëm gjashhtë numrash!

— Po sido ti, të jetë dymbëdhjetë? Si do të mundet me u-rregulluem në kohën e pushimevet, kur nxanësit s'janë në shkollë?

— Mund të rregullohet fare mirë: të tre numrat, korrik, gusht, shtatuer. bashkohen në një numur të math me emoin «Numri i

mbas rrymës së shekullit: herë ta naltësojmë dhe herë ta ulim krejt poshtë? Mbi bodrumet, mbi gërmadhat, mbi cxaqet e mbi tokën përgjithënisht të kësaj fortese ndashti mbretënon heshtja shekullore, por ndënë cipën e 'tyne jetojnë kujtimet e njëj pashaj me shejtë dikurshëm që pret stërnipin e kritikës për me i thanë se ç' vjettë ka si njëri dhe si sundues! E në qoftë se deri ndashti dikush, i shtymë ma fort nga atdashedashunia i dritët, ka shkruar dishka mbi këtë ma tepër me fjalë lavdie e ledhatime kombëtare, mbaskëndej penda e historianit të vërtetë kritik këta kujtime, që po na thërresin kujdherë e që po na ndjekin kudo por si fantazma, duhet me i shoshitun mirë e bukur, sepse kështu e don ndërjegjia kombëtare.

St. Spase '32

Pushimevet» dhe shtypet në muajt e vjeshtës: kur nxanësit janë në shkollë. Ahere e dijmë ma qi jemi pajtimtarë të një reviste të plotë, qi jemi pajtuem në një rivistë me kujtimin e vërtetë të fjalës. E kështu si asht sot, ma mirë i paguej të hollat gjetkë, në një rivistë tjetër qi nuk e haron rruqën, dhe në kohën e duhuno fletët e saj çpalosen nga duert e mija. Apo s'kam të drejtë?»

Më duket shokët e mij kanë të drejtë; pikërisht ky asht shkaku qi pajtimtarëvet nuk u jepet t'i dëgjojnë pajtimet e tyne me rregull. «Po me se t'a nxjerrim revistën me rregull, thoni ju, ne s'kemi të holla?»—Po përse t'i dërgojmë të hollat, thanë pajtimtarët, kur nuk e dijmë qi revistën kemi me e marrë me rregull?»

Ja dy mendime të kundërt njëni me tjetrin; ja dy zjarre, qi bajnë revistën të digjet, apo ma mirë, të vdesë dhe të ngjallet shpeshë. Si me ia bamë për të siguruem jetesën e saj? Ma parë pajtimet të parapaguen; pastaj edhe një sakrificë e jueja. «Hë, ende e jona? do të thoni ju.» Po, po, e jueja. E di qi këtë punë e kemi bamë shpesh herë: ah, ato pemët e shkreta, qi të lëmojnë fytin mbas buke! Po s'mjafton, edhe një herë; edhe një herë, përse me vullnetin t'uej, qi stolisë faqen e parë të Normalistit, me dëshirën t'uej të zjarrtë, shëmbëllore, do t'i bani të kuptojnë shokët t'uej qi marrin rrogë të mos harrojnë e të jenë të bashkuem te Mëma e 'tyne, me revistën e tyne!

Zerqan 10|X|1934

I juej, M. Shehu '32

### PRIMUM VIVERE

Par luftës, Edison-i, çp kësi i fanëshmë, ugodit prej një gripi të rëndë. I shtënguar pra prej miqvet të vet, se pse ishte në rezik, thirrri doktorin dhe u kyqyr prej ti. Doktorin i dha një recetë, me të cilën Edison-i mori barë e duhur brënda në një shishe, dhe këtë e hodhi për një herë. Miqve të tij të çuditur u a çpëgon-te punën kështu: «Thirra doktorin të më kyqyrnjë dhe e pagova, sepse ay duhet të ronjë; mora në barnatore barin që caktonte receta, sepse barnatori duhet të ronjë, dhe pastaj shishen e theva sepse dhe unë duhet të ronj.»

Prej Ritos it

## Z.Z. Mësuëse, Mësuës dhe nxënës Normalistë.

Normalisti është shumë i nevojshëm për ne, se është e vetmja revistë në shtetin t' onë, ku munt të çfaqim mejtimin kaqe e kaq arësimitare dhe arësimitarë. Natyrisht më shumë për çështje që i përkasin punës s' onë.

Disa mësuës, që janë të vjetër dhe ara që nuku dijnë një gjuhë të huaj, kanë nevojë për lëndë dhe methodhë të rë mësimi. Pastaj shumë mësuës, që janë të rinj dhe që dijnë gjuhë të huaj, munt të jenë të nevojshëm për të çfaqurit e methodhave të reja pedagogjike.

Veç kësaj arësimitarët janë të përhapur në të gjithë Shqipërinë e vogël, që nuku e njohim mirë. Çdo tshat ka zakone më vehte. ka fjalë e konstrukte të veçanta në të folur, ka histori, këngë e vjersha shumë të bukura, që nuku i dijmë ne të tjerët.

Këto munt t'i mbledhi mësuësi e t'ua bëjë të njohur e të tjerve. Kjo ndihme këshu është një nevojë dhe detyrë për sicilin arësimitar.

Këto i dini të gjithë, po puna qendron se kush i ka fajet për revistën t' onë dhe ç' duhet të bëjmë, që të mnnt të dalë më me rregull dhe më e mirë?

Për këtë janë përgjegjës dy anë:

Ana e mësuësve me mësuësit, dhe ana e nxënësve, që e kanë marrë përsipër t'a botojnë.

Të parët duhet ta ndihmojnë Normalistin me ndihmën morale që përmëntmë, pastaj dhe pak ndihmë materiale.

Të dytët duhet të kujdesen më shumë për rregullimin e smadhimin e lëndës edhe për ta qitur më me rregull.

Ndihma e anës së parë e bashkuar me kujdesjen e anës së dytë, plotësojnë njëra t' tjetrën. Se dyke dërguar ndihmë, do të kenë lëndë për te shpejtuar e për ta qitur më mirë Normalistin; pastaj dyke u-kujdesur për rregullimin e shpejtimin, nga ana e nxënësve do t'iu bëjë zemra mësuësve dhe mësuësve, që të shkruajnë dhe që ta ndihmojnë revistën e tyre. Përkundrazi, në qoftë se s' del me rregull, të gjithëvev iu ik dëshira jo vetëm për ta ndihmuar, por edhe për t'a kënduar.

Puna që kanë marrë përsipër nxënësit e Normalës, është një punë e tepërme, një gjë ideale, për të cilën duhet të lavdohen.

Le të shpresojmë për këto që thamë, po dyke vepruar.

T. Gushe '31.

## MALLIT T'IM

Po shkon kot një vaj' i tërë,  
I tërë loti kalon:  
Thithet malli yn' i gjërë,  
Si gjak' zëmre, kur pikon.

Ah! Po s' di qepall' e varfër  
S'më përletet më nashti  
Si më par' e sa më afër  
Po, m'u shduk çdo ëmbëlsi..

Po u-shduk ndjenj' e stërholl  
Ndenj' e fatit, që m'u nxi,  
S' fundit çdo fjal' e folur:  
Gaz' i shpejt' u kthe në zi.

Zi e rëndë që më tret  
Zi e rëndë më pushton:  
Fjal' e butë, që më vret  
Krah' i saj s'më përfaqon

Dhe po tretim paskëtaj  
Si një dritë, e si një hije  
Dot' shterohem m'asandaj:  
Do t' humbas prej dhëshurij  
Ali Kuçi '34

K A N G Ë

## LARG VENDLINDJES

*Rendit „37“ (S. N. S.)*

qëllimi i shëjtë i të cilit është me prurë  
n' atdhë eshtnat e Naim Frashërit  
ia kushton këtë kangë  
shoku i 'tyne.

O atdhë sot unë larg teje  
jetën shkoj të gjithë n'vajtim,  
Pa kend t'afërm për bri meje  
jam i s'mundë e s'gjëj dot ngushllim,

Pse qysh ditën që u ndashë  
Tejet n'murg, o i jem atdhë,  
Ditë të hardhë unë kurrë nuk pashë,  
Vetëm Voje të prapmë

Atje larg, po n'at bregdeti  
Nan' e babë kam lanë tu' qa,  
Kam lanë t'dashmit un' i shkreti,  
Zemrën motrën, shpirtin vlla

E n'kët shtrat shtrimun n'vetmi  
Jam i shkretë tu menduë:  
Kur m'nji vorr t'jem gjatas shtri,  
T'dashmet t'mij kush me kallxue?

Nata krepë e pyje t'errta,  
Ku strugë shqypja Zoqt e vet,  
Ku njomë lumi fusha t'blerta  
E shqiptari qetë i nget;

N'ato fusha plot gjelbrime,  
Ku byllbylat kndojnë n'prandverë,  
Atje dëshron Zemra ime  
Me bā prehjeu e përharë.

Ah, kish t'mujshem m'u-shëruë  
Prej ksaj smundje ra n'burri,  
Sa n'atdhë flutrim me shkuë  
E m'u-çmallë me djemt e ri;  
Kët flamur, qi mbshtjellë mba n'gj  
E dishmuë m'ka për shqiptar  
Zemrës 'tyne porosi  
M'e lanë rreth t'qendisët n'ar!

Oh, Shqipni! O lule Maji,  
Qi me t' pa tash s'kam mē shpresë,  
Muë për ty po m' çohet vaji,  
M' gulshon zemra e po vdes!  
Oh, po vdes në dhe të huëj.  
I pa njoftun në vetni;  
Fjalën "vdiq," do t' a lā ndokuëj  
Me t'a prumun ty Shqipni.

E, kur rasti t' bij më shkuëmun  
Kndej pari një shok shqiptar.  
E n' gur t' varrit ka më knduëmun:  
"Shqipni, ktu t' fllen një atdhetar!,"  
Aty vetë kam me qënë vdekun,  
Pa një kunorë vū mbi kryë  
Pse kunora për muë është tretun  
Tuj punuë për ty Shqipni!

M. Shehu '32

# KOPESHTI SHKOLLOR

Kopësht shkollor quhet ai kopësht fëmijësh, i cili, zakonisht, ndodhet i thurur pranë një shkollë e fillore dhe në të cilin mbillen e rriten nga nxënësit, të udhë hequr prej mësuesit, lule, barishta, drurë e pemë të gjithfarshme.

Sistemi i kopështeve shkollore u vu në veprim prej shumë vjetesh më parë në gjith shtetet e qytetëruar, si në Gjermani, Angli, Francë, Amerikë etj.

Edhe në Atidhenë t' onë: është dhënë qysh prej kohe rëndësi e duhur prej P. T. Ministrive Ekonomis e Arsimit për të krijuar kopështe shkollore. Kjo e fundit në programën e shkollave fill faq. 20 N. 27 dhe në Dekret-Ligjin organike të saj nen 73 shënon: Me përgatitë vende në kopësht të shkollës për prova të bujqësisë etj. Për këtë shkak kjo ka caktuar javën e Dr nit.

Kjo detyrë është kuptuar prej mësuesvet, por disa, kushedi, për shkaqe të ndryshme, e kanë lënë mbas dore. Si do qoftë duhet t'a ndiejmë shpirtërisht gëzimin e math, që munt të shkaktojë punimi, cuditja e luleve, bimëve me gjith ata që do të merren me to. Prandaj të gjithë për një qëllim «dashuri e përparim bujqësor» duhet të gjejmë mënyra e ti shpikim pengimet përta i përket krijimit e përgatitjes së kopështit shkollor.

## Për Ç qëllime duhet krijuar kopështi shkollor

Të gjith' e dimë se gjendjet gjeologjike e klimatike e karakterizojnë Shqipërinë nënjë bujqësie. E dimë se lumtëria e jonë është lidhur ngushtë me t'ë të gjithë prej saj presim, por, mjerisht pak janë ata të cilët dëshërojnë të quhen bujq e të merren me t'ë. Këjo shkakton — turp për ne që shpesh herë të jemi të shtërënguar e të sjellim—për ushqimin t' onë—sende nga shtete të huaj prej natyre ndoshta dhe më pak bujqësor se vendi i ynë.

Bujku Shqiptar i përbuzur prej qytetarve që s' kanë ndërgegjeje bujqësore dhe sjellin sende të këtilia nga shtetet fqinj dëshpërohet humbet kuximin, le punën e tij dhe herë vete në qytet e rri pa punë, herë rri në katund i dëshpëruar dyke prodhuar sa për ushqimin e tij.

Kuptohet lehtë se me bujqër të këtille-me zemër të thyer—s' mund të përparojë bujqësia në vendin t' onë.

Për të ndryshuar këtë mentalitet, e këtë gjendje të vajtushëm duhet, për veç masavet të të tjëra, të mbështetim shpresa të mëdha përmirësimi në kopshtet shkollore, me qëllimet e punimi t' të cilave do të ndriçohen qytetasit dhe do të marrë quxim bujku.

Kështu me anën e kopshteve shkollore do të mundim t' ja mbrijmë shunë qëllimeve, diçja prej të cilave po i bisedojmë.

E fillojmë që nga përlitimet që do të ketë shkolla; dyke mbjellë lule, bimë, pemë në kopështin shkollor dhe rreth shkollës, zbukurohet pamja e saj e bëhet më simpatike dhe më këndëshme si për mësuesin ashtu dhe për nxënësin. Kështu që të dy i shtrohen punës më mirë. Që të dy do të ngushëllohen e do të kënaqen. Mësuesi me anën e kopështit shkollor do të mundë ti bëjë mësimet më intuitivisht. Nxënësit dyke u-mbledhur në orët e pushimeve rreth kopshtit shkollor bisedojnë si burra të mëdhenj për punimin e rregullimin e tij; kuptojmë se mjeshtëria bujqësore është e nderhme, e shëndetshme, është një shkencë. Ju shvillohet ndjenja e të bukuri, iu përmirësshet karakteri, mësohen të vërejnë me kujdes, të ndihmojnë njeri t' jetrin e të ndjejnë një kënaqësi.

Kjo kënaqësi prej punës së vet, dyke u-përhapur me anën e nxënësuet në shtëpiat e tyre, do të gëzojë familjet, do të duan dhe këto të bëjnë banimin më tërheqës. Kjo do t'iu ngjallë djelmëve bujqë dashurinë nëpër punë. Atëherë do të formohet një ide e kundërtë nga ai që është sot, përta i përket punës dhe bujqësisë.

Mb' anë t' jetër punët dhe lëvizjet që do të bëhen në kopshtin shkollor nuk do të lenë pa e prekur popullin që viziton këtë. Kështu do të krijohet një lëvizje me qëndër kopështin shkollor. Kjo lëvizje do të jetë e vlefshme jo vetëm për nxënësit, por edhe për prindërit e tyre, pse do të përfundojë në një punë tërheqëse e fitimtare.

Do të gjenden ç' punime janë më të mira për qarkun, si mbrohen këto kundra armiqëve dhe

ç' shërbime duhet të iu bëhen këtyre që i apin shpërblimet e duhura.

Atëhere prej kopështit shkollor do të burojë dija, e cila do të na hushëheqë në përparimin e bujqësisë. Do të bëhet d. m. th. kopshti shkollor 'fener' i ndritshëm i përparimit bujqësor.

### Krijimi, ndarja dhe puimi i kopështit shkollor

Kopështi shkollor përgjithësisht krijohet në qarkun e shkollës. Në mungesë të vëndit të duhur duket të kërkohet tjetër, por jo larg kësaj. Kur mungon dhe kjo atëhere përdorim saksialt ose arkat.

Vendi i caktuar për kopësht shkollor duhet të përbëhet prej toke të mirë ta shikojë dielli, të jetë i mbojtur nga erërat e ftohta.

Çdo kopësht shkollor simbas shkollës e madhësisë munt të përbëhet prej pjesësh me formë të ndryshme, si rrethi, gjysmë-rrethi kand-drejtë trikëndëshi, trapeza, vezake etj. Të jenë ndarë bukur dhe midis tyre të bëhen rrugë. Toka e

këtyre pjesëve të jetë më lart 10-20 centimetra prej rrugës dhe buzët të rrethuara me lëndinë, gurë ose dega shelgu Këtu purohen: 1) Nga çdo klasë e periudhës së dytë, 2) nga grupe nxanës të mëdhenj dhe nga nxënës të veçantë. Punimi për çdo klasë, grup ose nxënës të veçantë duhet të jetë i njëjtë për të mundur të vëzhgohet përfundim i tyre.

Mbassi të ndahet sipërfaqja e kopshtit shkollor bëhet punimi i thellë 40-50 cm., qërohen gurët e barërat, plerohet e mbillen lulet e barishtat.

Për krijimin e mirë-mbajtjen e një kopshti shkollor duhet të sigurojmë: Një sipërfaqje toke të mirë, të kemi ujë prej kalitetit të mirë, vegla dhe barna për luftimin e insekteve e mikrobeve, plehë kafshës e kimik, sigurim kundër vjedhësve, fara kalitetit të mirë për shumëzimin e luleve, barishtave, bimëve, një program punimi dhe libra udhëzimesh dhe më së fundi zbatim i mirë i programës.

P. Leka

### VJERRSHA PËR FËMIJË

## STINËT E VITIT

I Dallëndyset erdhë  
Bilbilat këndojnë  
Në çerdhet u derçhë  
Si kanë zakonë

II Me lule livadhet  
E bar të paprerë  
Jan' mbushur dhe malet  
Se është Prandverë

I Tani bujku shihet  
Me drapër në dorë  
Që ulet dhe ngrihet  
Grunin duke korrë

II Nga shkolla fëmijtë  
Dalinë për erë  
Nëpër malësitë  
Se jemi në verë

I Është hapur shkolla  
Fëmijtë po shkojnë  
Ca kan' rrush ca molla  
Mësonjësit ja çojnë

II Po zen bien fletët  
Po vilet ç'do vreshtë  
Në zgju futen ble ët  
Se jemi në vjeshtë

I Qielli është mirë  
I përngjan skëterrës  
Ujë është ngrirë  
Nga thellim i erës

II Gjithë njerzit ngr hen  
Ndëgjojnë fëshllimën  
t' pemve që vëshgohen  
Se jemi në dimën  
Gjorgj V. Simo '35



## Shtypëshkronja-Kartoleria PEPPO & MARKO

Shtypëshkronja janë shtyp me mjeshtëri të rallë çdo sent q'i përket kësaj mjeshtërie.

Çmime të pa-konkuruëshme.

Kartoleria janë është e plotësuar me mashinari Moderne, dhe kësaj mer përsipër bërjen e radhëve shkollare, kartës shkrimi, radhëve muzikës, regjistrave Tregëtare, si dhe çdo lloji q' i përket kartolerisë.

Pranojmë porosira nga gjith viset e Shqipërisë.

Shitë vetëm me shumicë.

Kalendari i vitit 1935 deli dhe shitet në çdo Librari



## STOP!

**NORMALISTA,**

Çdo send që kini nevojë mund t'a gjeni më të mirë dhe më të lirë ke dyqani

## Sulejman Kurani & Vlla

Kartoleri Komplet, dhe libra shkollare.

Këtu shiten dhe broshurat e Bibliotekës së të rinjve si dhe Normalisti

Muzeu i Shkollës Normale